



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. dokumentit: 22.24.1-2011-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje e përgjithshme	6
1 Hyrje.....	8
2 Opinioni i auditimit	10
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar	11
4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	12
5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëria me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit.....	13
6 Menaxhimi Financiar	14
6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake).....	14
6.2 Shpenzimet.....	15
6.3 Pasuritë	18
6.4 Borxhet	19
6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor	20
7 Kontrolli mbi menaxhimin	20
7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	20
7.2 Auditimi i Brendshëm	21
8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e komunës së Vushtrrisë..	23
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	24
Shtojca II. Rekomandimet e vitit të mëhershëm	26

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
LAB	Ligji për Auditimin e Brendshëm
LMFPP	Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik nr.03/L-241 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-042 në fuqi prej 05.10.2011
MF	Ministria e Financave
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm
OB	Organizatë Buxhetore
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
OVL-UÇK	Organizata e Veteranëve të Luftës – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)

SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKA	Zyrtar Kryesor Administrativ

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF.

Sipas opinionit tonë PVF në të gjitha aspektet materiale prezantojnë *pamje të drejtë dhe të vërtetë*.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se Komuna e Vushtrrisë nuk i ka shpalosur në mënyrë të plotë dhe të saktë informacionet për pasuritë dhe detyrimet kontingjente në PVF 2011. Kjo nuk ka ndikim në opinionin mbi PVF të hartuara në pajtim me SNKSP sipas kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA 400: *Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes*).**

Ne vlerësojmë bashkëpunimin e komunës së Vushtrrisë me ZAP. Progresi i arritur në adresimin e rekomandimeve të vitit të kaluar, tregon përpjekjet e komunës së Vushtrrisë për menaxhim më të mirë financiar.

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të këtij raporti.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se sistemi i kontrollit të brendshëm të komunës së Vushtrrisë nuk funksionon sa duhet. Dobësitë e identifikuara duhet të adresohen në mënyrë që të përmirësohet performanca e komunës suaj.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguron:

- Adresimin e të gjitha çështjeve të ngritura nga auditimi ;
- Se janë ndërmarrë masa për ngritjen e normës së inkasimit të të hyrave ;
- Se procedurat e prokurimit zhvillohen duke respektuar të gjitha kërkesat e ligjit të prokurimit;
- Subvencionet janë dhënë bazuar në rregulloret në fuqi;
- Shpalosjen e plotë të detyrimeve kontingjente;
- Procedurat e rekrutimit të personelit janë kryer në pajtim me kornizën ligjore;
- Azhurnimi i dosjeve të personelit; dhe
- Regjistri i pasurive komunale të jetë i plotë dhe i saktë.

-
- Menaxhmenti i komunës së Vushtrrisë është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi PVF për vitin 2011 dhe është zotuar që do të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës së Vushtrrisë të përgatisë PVF në pajtim me Rregullën Financiare Nr.07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Vushtrrisë. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme, Pasqyrat Financiare nëntë mujore si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e komunës së Vushtrrisë, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF e komunës së Vushtrrisë në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse PVF e komunës së Vushtrrisë janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat vjetore financiare
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;

-
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
 - Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në komunën e Vushtrrisë.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF të komunës së Vushtrrisë, SNISA-të përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën I.

2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë PVF në të gjitha aspektet materiale prezantojnë *pamje të drejtë dhe të vërtetë*.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se Komuna e Vushtrrisë nuk i ka shpalosur në mënyrë të plotë dhe të saktë informacionet për pasuritë dhe detyrimet kontingjente në PVF 2011. Kjo nuk ka ndikim në opinionin mbi PVF të hartuara në pajtim me SNKSP sipas kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA 400: *Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes*).**

3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Opinion i auditimit të PVF 2010 të komunës së Vushtrrisë ishte *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes* (Informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogaritë e arkëtueshme ishte jo i plotë dhe i pasaktë).

Në raportin tonë të auditimit të PVF të vitit 2010 janë dhënë dhjetë(10) rekomandime. Komuna e Vushtrrisë kishte përgatitur një Plan Veprimi i cili adreson rekomandimet e dhëna nga ne, për vitin 2010.

Komuna e Vushtrrisë kishte adresuar 8 (tetë) rekomandime pjesërisht, ndërsa 2(dy) janë të pa adresuara. Për përshkrim më të hollësishëm të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih shtojcën II

Konkluzioni

Menaxhmenti i komunës së Vushtrrisë nuk ka arritur që të adresojë të gjitha rekomandimet tona. Mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka shkaktuar të njëjtat mangësi gjatë vitit 2011.

4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në PVF kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela nr. 1 Shpenzimet buxhetore dhe burimet e fondeve

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Pranimet/ Shpenzimet 2011	Pranimet/ Shpenzimet 2010
I. Gjithsej pranimet dhe transferi i donacioneve	12,483,567	13,071,484	12,828,057	10,277,261
Granti i Qeverisë - buxheti	11,168,567	11,178,565	11,009,393	8,793,559
Të bartura nga viti i kaluar		322,270 ¹	322,270	317,771
Të hyrat vetjake	1,315,000	1,315,000	1,240,745 ²	1,091,022
Donacionet e vendit		204,050	204,050	74,909
Donacionet e jashtme		51,599	51,599	0
II. Gjithsej shpenzimet	12,483,567	13,071,484	12,365,621	9,954,991
Paga dhe Mëditje	6,941,597	6,976,528	6,896,394	5,500,157
Mallra dhe shërbime	980,051	1,105,640	1,050,628	888,289
Shpenzimet komunale	233,822	233,822	214,660	228,021
Subvencionet dhe transferet	159,862	159,862	159,853	155,822
Investimet Kapitale	4,168,235	4,595,632	4,044,086	3,182,702
Diferenca I-II			462,436	322,270 ³

Buxheti final i ndarë për vitin 2011 për komunën e Vushtrrisë ishte 13,071,484€ që krahasuar me buxhetin fillestar është për 587,917€ më i lartë. Ky ndryshim ka rezultuar për shkak të të hyrave vetjake të bartura nga viti 2010 në vlerë prej 322,270€, rritja e donacioneve të vendit dhe të jashtme në vlerë prej 255,649€ dhe 10,000€ të bartura nga niveli qendror për kategorinë e pagave.

¹ Të hyrat e bartura nga viti i kaluar

² Të hyrat vetjake të mbledhura në vitin 2011

³ Të hyrat vetjake të pa shpenzuara në fund të vitit 2010

Shpenzimet totale të komunës së Vushtrrisë për vitin 2011 ishin 12,365,621€ apo 95% të buxhetit të ndarë.

Diferenca në vlerë prej 462,436€ përfshinë donacionet e brendshme të pashpenzuara në vlerë 58,292€, donacionet e jashtme të pashpenzuara 6,057€ dhe të hyrat vetjake të pashpenzuara e në vlerë prej 398,087€ që barten në vitin 2012.

Konkluzion

Komuna e Vushtrrisë ka arritur një performancë të mirë buxhetore. Nga të dhënat e sipër përmendura duket se shpenzimet e planifikuara sipas kategorive janë në pajtim me periudhat kohore.

5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëria me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit

Draft Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës së Vushtrrisë të përgatitura më 31.01.2012 për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011 nuk ishin në pajtim me Rregullën Financiare nr. 07/2011. Ato ishin jo të plota dhe të pasakta, prandaj në gjatë procesit të auditimit kemi kërkuar nga Komuna e Vushtrrisë që Draft PVF të korrigjohen. Draft PVF-të e komunës, pas kërkesës sonë, janë korrigjuar dhe dërguar për herë të dytë në Thesar, mirëpo prapë në PVF finale, disa gabime kanë mbetur të pa korrigjuara, siç është: mos shpalosja e pasurive fikse, stoqeve dhe detyrimeve kontingjente.

Kërkesat e LMFP nr. 03/L-048 dhe Rregullës Financiare nr.07/2011.

- Pasqyrat Vjetore Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- PVF janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 31/01/2012 ndërsa të korrigjuara me 22.03.2012 dhe janë dërguar në MF;
- Pasqyrat Vjetore Financiare janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe;
- Te shënimi 29: Detyrimet kontingjente nuk janë shpalosur në vlerë prej 58,750€; dhe
- Shënimi 31: Përmbledhja e pasurive jo-financiare me vlerë nën 1000€ dhe me afat përdorimi më shumë se një vit, nuk është e plotë (nuk ishte përfshirë i gjithë inventari i shkollave të komunës).

Konkluzioni

Mos shpalosja e plotë e detyrimeve kontingjente në pasqyra financiare ka ndikim në pasqyrimin e drejtë të aftësisë së komunës në menaxhimin e detyrimeve. Po ashtu, edhe mos shpalosja e plotë e pasurive ndikon në prezantimin e pasqyrave si tërësi dhe pa mundëson marrjen e informacioneve nga ana e shfrytëzuesve.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se Pasqyrat Vjetore Financiare janë në pajtim me Rregullat Financiare dhe SNKSP sipas bazës së keshit, duke përfshirë edhe të gjitha shpalosjet e kërkuara.

6 Menaxhimi Financiar

6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2011 janë 1,315,000€, ndërsa ishin inkasuar 1,240,745€ apo 94% nga plani.

Nga 85 njësi mostre të rishikuara nga të hyrat e inkasuara, 35 ishin të tatimit në pronë, 29 nga taksat e biznesit, 5 për të hyrat nga qiradhënia e pronës, 8 nga taksë për leje ndërtimi dhe 8 nga taksat në transaksione, Ne kemi vërejtur se:

- 11 obligues të tatimit në pronë nuk kishin shlyer obligimet e tyre, që kapnin një vlerë prej 2,583€; dhe
- 7 tatimpagues për taksa biznesi, nuk kishin paguar obligimet e fundvitit prej 1,298€.

Bazuar në rishikimet tona, përveç mos pagesës me kohë, nuk kemi hasur në ndonjë mangësi tjetër, sa i përket inkasimit të të hyrave nga komuna. Andaj, mund të konkludojmë se komuna ka inkasuar të hyrat në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Konkluzion

Në përgjithësi, komuna ka menaxhuar mirë të hyrat vetjake. Shkalla e mbledhjes së të hyrave është mjaft e lartë dhe konkluzioni është se komuna kishte hartuar një Plan real mbi të hyrat vetjake. Por, ajo që bie në sy është fakti se komuna nuk ishte në gjendje t'i shpenzoj të hyrat e mbledhura, dhe rreth 34% të tyre ishin bartur në vitin 2012.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Në marrjen e masave për rritjen e normës së inkasimit të të hyrave nga taksa e bizneseve dhe tatimit në pronë; dhe
- Të përmirësoj politikat buxhetore përkitazi me shpenzimet e të hyrave vetjake.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Prokurimi

Për vlerësimin e procesit të prokurimit dhe verifikimin e rregullsisë së pagesave për blerjet përmes prokurimit, kemi përzgjedhur një mostër në vlerë prej 2,148,331€ nga totali i kontratave të nënshkruara prej 4,840,959€ apo 44% të tyre.

Gjatë rishikimit kemi vërejtur:

Kryerja e pagesave pa raporte të pranimit

Te kontrata për pastrimin e objekteve shkollore në shumë 77,770€, Drejtoria e Arsimit i ka paguar Operatorit Ekonomik dy fatura nga 4,481€ për muaj, pa pranuar asnjë raport nga drejtoritë e shkollave për kryerjen e këtij shërbimi.

Vonesa në ekzekutimin e punimeve sipas planit dinamik

Punimet për “Ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica në fshatin Prelluzhë” në vlerë prej 384,280€ sipas kontratës kanë filluar me dt.14.08.2011 dhe sipas planit dinamik është dashur të përfundojnë me dt.12.11.2011 por ende nuk janë përfunduar. Pagesat i janë bërë sipas situacioneve të dorëzuara dhe të përcjellur me raport të organit mbikëqyrës në vlerë prej 374,673€. Vlera e mbetur për pagesë është 9,607€

Mungesë e komisionit të pranimit të mallrave

Nga buxheti i komunës së Vushtrrisë është paguar fatura në shumë 5,449€ për Qendrën për Punë Sociale dhe fatura në shumë 15,382€ për Kujdesin Primar Shëndetësor për furnizim me naftë për ngrohje. Komuna e Vushtrrisë nuk kishte emëruar një komision për pranimin e naftës. Dy furnizime me naftë ishin pranuar nga një zyrtar, ndërsa një furnizim ishte pranuar nga dy zyrtarë të rastit.

Konkluzioni

Nga rastet e përshkruara me lartë, mund të konkludojmë se Komuna e Vushtrrisë nuk ka kontrollë adekuate mbi proceset e prokurimit. Kryerja e pagesave pa raporte të pranimit, shton rrezikun që komuna të bëjë pagesa për punët të cilat fare nuk janë kryer.

Mungesa e një komisioni për pranimin e derivateve për ngrohje shton rrezikun që sasia e mallit të pranuar të mos korrespondoj me sasinë dhe cilësinë e kërkuar.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Që pagesat të kryhen vetëm pasi të jenë pranuar raportet për mallrat e pranuar; dhe
- Të emërojë komision të veçantë për çdo furnizim me naftë për ngrohje, në mënyrë që të konfirmohet sasia dhe cilësia e furnizimit.

6.2.2 Blerjet tjera

Gjatë testimit të pagesave të kryera pa procedura të prokurimit në vlerë prej 56,297€, janë identifikuar këto dobësi:

Shpenzimi i parasë pa procedura të prokurimit dhe mungesë të dëshmive

Nga zyrtari i Drejtorisë së Arsimit janë tërhequr 5,000€ avanc për udhëtim zyrtar për vizitë në Turqi. Nga ky avanc janë blerë bileta aeroplani, pa procedura të prokurimit, në AT "Fibula" në Prishtinë me para të gatshme në shumë 4,114€. Po ashtu, komuna e Vushtrrisë nuk mban dëshmi të mjaftueshme për shpenzimin e bërë, siç janë biletat e aeroplanit për secilin zyrtar që ka udhëtuar.

Konkluzioni

Pagesa me para të gatshme dhe pa procedura të prokurimit në këtë rast është shkelje e LMFP-së dhe LPP-së dhe si e tillë rrezikon që përdorimi i parasë publike të jetë jo racional.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Që për të gjitha shpenzimet të mbahen dëshmi relevante dhe ato të bëhen në pajtueshmëri me ligjet në fuqi .

6.2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti i ndarë për paga dhe mëditje për vitin 2011 ishte 6,976,528€, ndërsa shpenzimet janë 6,896,394€. Për të testuar rregullsinë e pagesave dhe procedurat e rekrutimit të personelit, ne kemi përzgjedhur 90 njësi mostre dhe kemi vërejtur se komuna e Vushtrrisë nuk ka kontrole të mjaftueshme në menaxhimin e burimeve njerëzore. Për më gjerësisht, kjo pjesë është e përshkruar në kapitullin e kontrollit të brendshëm.

6.2.4 Subvencionet dhe transferet

Subvencionet e planifikuara për vitin 2011 ishin 159,862€, të cilat pothuajse në tërësi ishin shpenzuar. Mostra e testuar mbulon 81,093€ të pagesave për subvencioneve të dhëna.

Disa nga parregullsitë e identifikuar janë përshkruar në vijim:

Mosrespektim i rregullores për subvencione

Kuvendi Komunal në Vushtri ka aprovuar Rregulloren për procedurat e dhënies së subvencioneve. Në emër të Zyrës së Kryetarit i është dhënë subvencion në vlerë 5,000€ për OVL-UÇK, duke anashkaluar procedurat e përcaktuara me rregullore. Në këtë rast subvencioni është ndarë me vendim të Kuvendit Komunal me numër 134/11, por nuk ka kaluar përmes Komisionit dhe Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, ashtu siç kërkohet me Rregulloren e brendshme të komunës.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka ndarë subvencion në vlerë prej 1,500€ në emër të ndihmës mjekësore. Subvencioni është ndarë me Vendim të Kuvendit numër 164/11, por pa kaluar përmes Komisionit dhe Drejtorit të DSHMS, ashtu siç përcaktohet me Rregulloren e brendshme.

Mos raportim i shpenzimeve nga përfituesit

Komuna e Vushtrrisë në rastin e dhënies së subvencioneve për entitete jopublike dhe përfitues individual, nuk ka pranuar raporte të shpenzimeve në këto raste:

- Subvencion për OVL-UÇK, Vendimi Nr. 72/11, në vlerë 3,600€ nga DSHMS; dhe
- Subvencion për Klubin e Boksit "Kosova", Vendimi Nr. 75/11, në vlerë 500€ nga DSHMS.

Ndarja e subvencionit nga drejtoria jo-përkatëse

Komuna e Vushtrrisë ka ndarë subvencione për klubet sportive KK Box "Kosova" dhe Kbox "Kosova" në vlerë 1,000€ gjegjësisht 500€, të cilat janë paguar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Kjo nuk është në pajtim me rregulloren për ndarjen e subvencioneve.

Ndarja e subvencionit për përfitues individual pa marrëveshje mirëkuptimi

Gjatë auditimit kemi hasur në tre raste që komuna e Vushtrrisë ka ndarë subvencione, por nuk ka bërë marrëveshje mirëkuptimi me përfituesit.

- Në emër të Zyrës së Kryetarit janë ndarë subvencione në shumë 27,741€ si dhe nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 23,249€ për material ndërtimor për rindërtim të shtëpive për 28 raste sociale. Me këtë rast komuna e Vushtrrisë nuk ka lidhur marrëveshje për mënyrën e shfrytëzimit të subvencioneve nga ana e përfituesve.

Konkluzioni

Mos respektimi i procedurave të përcaktuara me Rregulloren e brendshme të Aprovuar nga Kuvendi Komunal flet për dobësi të kontrolleve. Po ashtu, ndarja e subvencioneve nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për klubet sportive është jashtë natyrës dhe objektivave të kësaj drejtorie dhe veprim i pa autorizuar.

Ndarja e subvencioneve pa bërë marrëveshje mirëkuptimi me përfituesit është në kundërshtim me kërkesat e Rregullës Financiare të Thesarit 02 për shpenzimin e parasë publike dhe rrezikon që paraja publike të mos shpenzohet për qëllimet e komunës.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Që të gjitha subvencionet të ndahen, duke respektuar të gjitha procedurat dhe kriteret që përcaktohen me Rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve;
- Që të gjitha subvencionet, si për përfitues individual apo entitete publike dhe jo-publike, t'i ndajë pasi të ketë bërë marrëveshje mirëkuptimi me përfituesin; dhe
- Që nga të gjithë përfituesit e subvencioneve të kërkojë raportim të shpenzimeve brenda një afati të arsyeshëm.

6.3 Pasuritë

Komuna e Vushtrrisë ka dy zyrtarë të pasurisë të cilët kanë ndjekur trajnimet e duhura dhe janë certifikuar për këtë fushë. Nga rishikimi i regjistrit të pasurive dhe inventarit, njëkohësisht nga intervista me zyrtarët përgjegjës, kemi vërejtur se pasuritë me vlerë mbi 1,000€ janë regjistruar në regjistrin e pasurive në SIMFK. Vlera e pasurive është 33,018,283€. Komuna e Vushtrrisë kishte instaluar edhe programin për regjistrim E-pasuria, ku janë regjistruar pasuritë me vlerën nën 1,000€, vlera e të cilave ishte 65,667€.

Regjistër jo i plotë i inventarit të shkollave

Mangësi në procesin e regjistrimit të pasurive është vërejtur tek regjistrimi i inventarit të shkollave në territorin e komunës së Vushtrrisë. Të dhënat e regjistrimit për inventar janë kompletuar vetëm për pesë shkolla nga gjithsejtë 47 shkolla.

Mungesë e dokumentacionit për projektet bashkëfinancuese

Ne nuk kemi arrit të sigurojmë dokumentacionin e duhur për projektet e bashkë financuara me Qeverisjen Qendrore ose atyre projekteve që janë financuar në tërësi nga Qeverisja qendrore. Lidhur me këtë, komuna e Vushtrrisë, i është drejtuar me shkresa zyrtare institucioneve përkatëse, si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por nuk ka marrë përgjigje.

Konkluzion

Komuna e Vushtrisë nuk ka arrit ende të kompletoj regjistrin përfundimtar të pasurive që ka në posedim. Mungesa e një regjistri të tillë ndikon në menaxhimin efektiv për të ruajtur pasuritë nga humbja dhe keqpërdorimi, si dhe në prezantimin jo të drejtë tek shfrytëzuesit e PVF-ve.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Regjistrimin e të gjitha pasurive të komunës, në pajtueshmëri me kërkesat e UA 21/2009 për menaxhimin e pasurive qeveritare.

6.4 Borxhet

6.4.1 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të viti 2011 ishte 128,910€. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2012.

Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor

Nga shuma e obligimeve të pakryera që arrin vlerën 128,910€, më shumë se gjysma e këtyre faturave kishin kaluar afatin ligjor të pagesës (30 ditë). Pjesa më e madhe e këtyre obligimeve ka të bëjë me mallra dhe shërbime dhe investime kapitale.

Një nga shkaqet që kanë ndikuar në mos kryerjen e këtyre obligimeve janë mungesa e mjeteve buxhetore sidomos tek shërbimet publike për shkak të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore direkt nga Thesari.

Konkluzioni

Rritja e obligimeve të pakryera për vitin 2011 në shkallë prej 16% në krahasim me vitin e kaluar si dhe shkaqet e mos kryerjes së këtyre obligimeve tregon se duhet shtuar kontrollet rreth menaxhimit të borxheve.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Se do të paguhen faturat brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

Komuna e Vushtrrisë kishte përgatitur:

- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Draft Plani i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF;
- Raportin e performancës për komunën e Vushtrrisë;
- Raportin vjetor të punës 2011 për komunën; dhe
- Planin e adresimit të rekomandimeve.

7 Kontrolli mbi menaxhimin

7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Edhe pse komuna e Vushtrrisë ka të dizajnuar një sistem të kontrollit të brendshëm, dobësitë kanë të bëjnë me funksionimin e tij efektiv.

Shpërblimi me kontratë OE të papërgjegjshëm, kryerja e pagesave pa konfirmim nga organi mbikëqyrës mbi punët e kryera, dorëzim-pranimi i mallit, furnizimi pa praninë e një komisioni dhe pagesat me para të gatshme dhe pa procedura të prokurimit, janë disa nga mangësitë e kontrolleve të prokurimit

Kontrolle të pamjaftueshme kemi vërejtur edhe te dosjet dhe rekrutimi i personelit. Me konkursin e shpallur nga DKA për plotësimin e vendeve të lira të punës të personelit arsimor për vitin shkollor 2011-2012 janë pranuar edhe shtatë punëtorë tjerë emrat e të cilëve nuk figurojnë në procesverbalin e komisionit pranues. Përzgjedhja e pesë kandidatëve për zëvendësim (për punëtorët që kanë shkuar në pushim të lehonisë) është bërë pa procedura të rekrutimit. Ndonëse në numër të kufizuar, ne gjithashtu, kemi hasur në dukurinë e mungesës së kontratave të pa nënshkruara nga ana e punëmarrësit

Në shumë raste, në dosjen e punëtorit nuk figurojnë kontrata e fundit por vetëm vendimi për ndërprerje të punës (në DKA).

Në njërën nga mostrat, në shpallje të konkursit nuk definohej saktësisht kualifikimi i kërkuar për vendin e caktuar të punës dhe nuk zbatohen format e reja të aplikimit për rekrutim, siç janë të parapara me Rregulloren 01/2010 Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Dosjet fizike të personelit ekzistojnë, por nuk janë të plota. Dosjeve u mungojnë origjinalet e vlerësimit gjatë procedurës së rekrutimit, përshkrimi i punëve, formulari i vlerësimit vjetor të punëtorit. Dosjet nuk përditësohen në baza të rregullta.

Më tutje, në shumicën e rasteve, Akt Emërimet janë të nënshkruara nga udhëheqësi i personelit, ndërsa sipas Rregullës 07/2010, neni 8.2 kërkohet që Akt Emërimin ta nënshkruaj Zyrтари Kryesor Administrativ i institucionit përkatës, ndërsa në disa raste akt emërimet nuk gjinden fare në dosje, siç kërkohet me nenin 4 dhe 5 të Rregullores 03/2010.

Konkluzion

Sistemi i kontrollit të brendshëm kërkon vendosje të udhëzimeve dhe procedurave të qarta të kontrolleve. Në formën aktuale, kontrollet e brendshme nuk ofrojnë sigurinë e duhur se objektivat e përcaktuara komunës po arrihen.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Rishikimin e sistemit aktual të kontrollit të brendshëm dhe aty ku janë identifikuar dështimet, të nxirren politika dhe procedura specifike me qëllim përmirësimi të kontrolleve.

7.2 Auditimi i Brendshëm

Për periudhën janar- dhjetor 2011 NJAB ka kryer pesë auditime të rregullta për të cilat janë përpiluar raporte finale, gjë që ka përmbyll realizimin e planit vjetor të auditimit, të miratuar nga ZKA. Po ashtu, NJAB ka hartuar raporte të rregullta për raportim tremujor ndaj NJQH/AB. Raportet finale të auditimit janë të punuar sipas standardeve. Auditimet e kryera mbulojnë rreth 50% të aktiviteteve të vitit 2011.

Rekomandimet e dhëna nga auditimet e kryera ishin 22. Prej tyre janë zbatuar 13, kurse 4 janë zbatuar pjesërisht dhe të pazbatuara ishin 5 rekomandimet e dhëna në raportin e fundit të auditimit. Kjo tregon se menaxhmenti i komunës së Vushtrisë kishte trajtuar me kujdes rekomandimet e dhëna nga NJAB.

Gjatë kësaj periudhe, Komiteti i Auditimit ka mbajtur 4 takime ku janë shqyrtuar raportet vjetor të NJAB për vitin 2010, analizimi i planit vjetor të NJAB për vitin 2011 dhe shqyrtimi i raporteve të auditimit të kryera gjatë vitit 2011, pastaj shqyrtimi i rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm të dhëna për vitin 2010 dhe Memoja e nëntëmujorit 2011.

Nga procesverbalet e këtyre takimeve ka rezultuar se:

- Plani vjetor i 2011 është zbatuar në tërësi nga ana e NJAB;
- Auditimet e kryera (në pajtim me planin e aprovuar për vitin 2011) janë në pajtim me ligjin dhe standardet e kontrollit dhe auditimit;
- Raportet e auditimit të NJAB përmbajnë rekomandime të qarta dhe të dobishme të cilat duhet të përmbushen;

-
- Ekziston një bashkëpunim i mirë në mes të menaxhmentit dhe NJAB;
 - Janë mbështetur rekomandimet nga Auditori i Përgjithshëm që në planifikimin e auditimeve, si fushëveprim i punës të jenë aktivitetet e vitit që kryhet auditimi; dhe
 - Që NJAB të mbështetet në vazhdimësi dhe të ketë pavarësi të plotë veprimi.

Konkluzioni

Konkluzioni ynë është se auditimi i brendshëm po kryen një punë të çmueshme. Kryerja e auditimeve të planifikuara që kanë rezultuar me gjetje të ndryshme dhe të përcjellura me rekomandime të duhura, ka kontribuar në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të komunës në sektorët përkatës.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Mbështetjen në mënyrë sistematike dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm, si dhe aktivitetet e tij t'i fokusoj në identifikimin e fushave më problematike gjatë vitit aktual; dhe
- Se këshillat apo rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, maksimalisht do të adresohen.

8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e komunës së Vushtrrisë

Konkluzionet e përgjithshme

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se Menaxhmenti i Komunës së Vushtrrisë ka bërë përparim të dukshëm në forcimin e kontrolleve dhe përmirësimin e menaxhimit financiar. Shumë nga mangësitë e identifikuar në vitin e kaluar nuk janë përsëritur, ndonëse nevoja për veprime përmirësuese të mëtutjeshme, duhet të jetë objektive permanente.

Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive vazhdon të mbetet sfida kryesore e menaxhmentit. Komuna e Vushtrrisë duhet bërë vlerësim e pasurive në të gjitha nivelet dhe të identifikoj cilat janë pasuritë aktive të saj. Pa një regjistër të plotë të pasurive, nuk është i mundur as menaxhimi i mirë i tyre.

Nevoja për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e organizatës, është një nga kërkesat bazike për ndërtimin e një strukture të mirë të qeverisjes. Procedurat e menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të jenë të qarta për të gjithë, në mënyrë që më pastaj të zbatohen. Niveli i duhur i njohurive dhe aftësive të menaxhmentit duhet të vlerësohet, për të siguruar zbatimin e suksesshëm të kërkesave të kësaj kornize.

Menaxhmenti i komunës së Vushtrrisë duhet që në mënyrë të përhershme të siguroj raportime të besueshme financiare dhe vlerësoj rrezikun e shfaqjes së gabimeve materiale dhe parregullsive në pasqyrat vjetore financiare. Rreziku duhet vlerësuar edhe tek menaxhimi i pasurive nën kushtet kur mungojnë evidencat dhe regjistrat e plotë.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Zhvillimin e një dialogu të mirëfilltë me Bordin e Drejtorëve dhe menaxherët tjerë për nxjerrjen e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të qarta për të gjitha proceset/aktivitetet e rëndësishme të organizatës, dhe e njëjta të jetë e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë.

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinioni. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinionin në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II. Rekomandimet e vitit të mëhershëm

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandi met plotësisht të adresuara	Pjesërisht të adresuara	Të pa adresuara
4.1 Buxheti i shpenzuar	Përmirësimi i planifikimit dhe shpenzimi i buxhetit në pajtim me planin		Shpenzimet kapitale ishin minimale në 6 mujorin e parë të vitit, në krahasim me planin.	
5. Pasqyrat Financiare	Shpalosjet e pasurive dhe llogarive të arkëtueshme nuk ishin të plota dhe të sakta.		Shpalosja e llogarive të arkëtueshme është bërë, kurse për pasuri jo.	
6.1 Të hyrat	Klasifikimi i të hyrave në harmoni me rregulloren mbi taksat komunale dhe evidenca e llogarive të arkëtueshme; Rritja e inkasimit të të hyrave në nivel të pranueshëm.		Klasifikimi i të hyrave mbi taksat komunale dhe evidenca e llogarive të arkëtueshme është implementuar, ndërsa Rritja e inkasimit të të hyrave nuk është implementuar.	
6.2 Shpenzimet	Hyrja në obligime pa zotim të mjeteve; Shpërblimi me kontratë i OE të cilët përmbushin kushtet ligjore dhe aplikimi i penaleve sipas kontratës.		Pjesa që i takon dhënies së kontratave OE të cilët i përmbushin kushtet ligjore dhe aplikimi i penaleve sipas kontratës nuk është bërë.	
6.2.1 Shpenzimet tjera	Çertifikimi i shpenzimeve të bëhet në pajtim me rregullën			X

	Financiare			
6.3 Subvencionet dhe transferet	Hartimi i një rregullore mbi dhënien e subvencioneve. Gjitha pagesat e bëra nga kategoria e subvencioneve të arsyetohen në pajtim me kërkesat ligjore.		Rregullorja mbi dhënien e subvencioneve është bërë. Arsyetimi i pagesave të bëra nga kategoria e subvencioneve nuk ë është bërë .	
6.4 Kompensimet (paga dhe mëditje)	Harmonizimin e koeficienteve në mes të kontratave dhe listës së pagave dhe kthimi i mjeteve ne Buxhetin e Kosovës.		Harmonizimi i koeficienteve dhe kthimi i mjeteve ne Buxhetin e Kosovës është bërë, ndërsa pajisja e të punësuarve me kontrata pune nuk ishte bërë.	
6.5 Pasuritë	Hartimi i një regjistri gjithëpërfshirës të pasurive.		Për pasuritë mbi 1000€ kanë hartu regjistrin,por për pasuritë nën 1000€ende nuk kanë të plotë	
7.1 Sistemet e kontrolleve të brendshme	Forcimi i kontrolleve në mënyrë që mos të krijohen obligime ndaj furnitorëve, pa mbulesë buxhetore			X
7.2 Auditimi i brendshëm	NJAB të fokusohet në auditimet që fushëveprim kanë vitin aktual.		Në gjashtëmuorin e dytë kryesisht kanë mbuluar vitin 2011	
Totali	10		8	2